

Specifikime teknike rrjeti i furnizimit me ujë

1 Gërmim dheu kanal plus mbulim

Në këtë zë pune përfshihet gjithë kostoja e punimeve që kryhen për prishjen e shtresave rrugore në se ka të tilla, gërmimin e kanalit deri në thellësinë e dhënë në projekt, transportin e mbeturinave në zonën e depozitimit të mbeturinave të miratuar nga komuna, mbulimin e kanalit si dhe normat e fitimit të kompanisë.

2 Furnizim vendosje tubi poliretan me diam 110x 6.6mm

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit dhe montimit të tubove PE PN6 me diametër të brendshëm 110mm dhe trashësi të pareteve 6.6mm , si dhe pjesëve speciale të nevojshme për bashkimin , e tubove në të njëjtin diametër sipas projektit, reduksionet e nevojshme, provën hidraulike si dhe normat e fitimit të kompanisë. Tubot duhet të jenë të shoqeruara me certificate cilesie nga prodhuesi.

3 Furnizim vendosje tubi poliretan me diam 100x6.3mm

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit dhe montimit të tubove poliretan me diametër të brendshëm 100mm dhe trashësi të pareteve 6.3mm dhe pjesëve speciale të nevojshme për bashkimin, e tubove në të njëjtin diametër sipas projektit, provën hidraulike si dhe normat e fitimit të kompanisë. Tubot duhet të jenë të shoqeruara me certificate cilesie nga prodhuesi.

4 Shtresë rëre mbi dhe nën tubacion

Në këtë zë pune përfshihet gjithë kostoja e punimeve që kryhen për blerjen dhe vendosjen e shtresës së rërës në shtratin e tubit polietilen. Në çmim futen dhe normat e fitimit të kompanisë.

5 . Shtresë betoni 10cm

Në këtë zë pune përfshihet gjithë kostoja e punimeve që kryhen për ndërtimin e shtresës të betonit C-12/15 me trashësi 10cm.

6. Furnizim vendosje saraqineske dn 80mm 16bar

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes , transportit dhe montimit të saraqineskës me diametër 100mm dhe 110mm, së bashku me boshtin e zgjatimit si dhe pusëtën sipërfaqësore prej gize të montuar mbi të.

Specifikime teknike depo uji

1 Gërmim dheu

Në këtë zë pune përfshihet gjithë kostoja e punimeve që kryhen për gërmimin e gropës të depos në thellësin e si në projekt, largimin e dherave të tepërta në vend depozitimin e miratuar nga Bashkia Maliq. Gjate gërmimit duhet treguar kujdes për krijimin e skarpave të qëndrueshme.

2 Gërmim në shkëmb

Në këtë zë pune përfshihet gjithë kostoja e punimeve që kryhen për gërmimin e gropës të depos në formacione shkëmbore në thellësinë si në projekt, largimin e mbetjeve të tepërta në vend depozitimin e miratuar nga Bashkia Maliq.

3 Mbushje me dhe

Në këtë zë pune përfshihet gjithë kostoja e punimeve që kryhen për transportin dhe mbulimin e depos të ujit në trashësinë e kërkuar si në projekt.

4 Mbyllje me bar

Në këtë zë pune përfshihet gjithë kostoja e punimeve që kryhen përpunimin e tokës , për blerjen e barit mbjelljes të tij ujitjes deri në mbirjen e tij të plotë në zonën e depos të ujit.

5 Beton M-12/15

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit të materialeve të nevojshme për përgatitjen e betonit M-100 , përgatitja dhe hedhja në vepër e betonit të kësaj marke , trajtimi i nevojshëm për periudhën e stazhionimit.

6.Beton M-300

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit të materialeve të nevojshme për përgatitjen e betonit 25/30, përgatitja e armaturave të dërrasës, hedhja në vepër e betonit, trajtimi i nevojshëm për periudhën e stazhionimit.

7.Suvatim me llaç cemento 1:4

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, të rërës, çimentos të nevojshme për përgatitjen dhe realizimin në vepër të suvave.Suvatimi duhet te krijoje siperfaqe te lemuar dhe te pa depertueshme nga uji.

8.Shtresë llustër cemento 1:2.

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, të rërës, së larë dhe çimentos të nevojshme për përgatitjen dhe realizimin në vepër të shtresës të llustrës.

9.Hidroizolim me dy duar letër guiane.

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes të materialit hidroizolues ashtu siç është parashikuar, vlera e praimerit, fiksimi i dy shtresave në objekt.

10.Furnizim vendosje tubo xingato plus rakorderi Ø4”

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportimit dhe montimit të tubove të xinguar me diametër 4”, rakorderive të nevojshme për montimin e tyre brenda depos të ujit si dhe pjesëve speciale për bashkimin me tubin e polietilenit me diametër 110x6.6.

11.Furnizim vendosje saraqineske 100mm 16bar

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit dhe montimit të saraqineskës me diametër 100mm, me fllanxhe së bashku me materialet ndihmëse si bulona dado etj.

12.Furnizim vendosje kosh thithje dn 100mm

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit dhe montimit të koshit të thithjes me diametër 100mm të galvanizuar ose inox.

13.Furnizim vendosje konstruksione metalike sipas detajit

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportin dhe montimin e konstruksioneve metalike të përgatitur, detaje fiksime etj. të cilat do të jenë të galvanizuara së bashku me materialet ndihmëse si dado e bulona etj.

14.Furnizim vendosje tub çeliku për ventilim dn 75.

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit dhe montimit të tubit të çelikut me diametër 150mm, lyerja e tij me bojë antindryshk.

15.Furnizim vendosje shkale metalike të galvanizuara max 3m.

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportimit dhe montimit të shkallëve metalike të galvanizuara të vendosura si në projekt.

16.Furnizim vendosje dërrasë jashtme metalike me ventilim

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportimit dhe montimit të dërrasës hyrëse në depo, vendosja e dritares të ajërimit lyerja me bojë antindryshk dhe dy duar boje vaji.

17. Furnizim vendosje dere metalike në rrethim.

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit dhe montimit të derës së rrethimit e pregatitur me diametër 2" dhe veshje tel gabioni 3.5x3.5.

18. Rrethim me tel gabioni me tre rreshta tel me gjëmbe.

Në këtë zë pune përfshihet çmimi i blerjes, transportit dhe montimit të materialeve të nevojshme si rrjetë me tel gabioni 3.5x3.5mm, tubo të gavalizuara me diametër 2", dhe me gjëmbe për rrethimin e depos të ujit sin ë project.

ING. PANAJOT PILANI



ING.PANAJOT PILANI